REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 564/23
Datë/Datum. 28.08.23
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubljanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

Nr. 564/2023

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, pas shqyrtimit të ankesës së OE " INTRAST " SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit "Sinjalizimi Horizontal, Vertikal dhe pajisjeve rrugore ne komunën e Gjilanit" me numër të prokurimit 651-22-10313-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL- GJILAN, Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Vjosa Gradinaj Mexhuani me datën: 28/08/2023, mori këtë:

VENDIM

1.**Hedhet si e palejuar**, ankesa e " INTRAST " SH.P.K. (Nr. të Protokollit 2023/0564) e datës 10/08/2023, e parashtruar për aktivitetin e prokurimit "Sinjalizimi Horizontal, Vertikal dhe paisjeve rrugore ne komunen e Gjilanit", me numër të prokurimit 651-22-10313-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL – GJILAN.

2.I lejohet, autoritetit kontraktues – KUVENDI KOMUNAL - GJILAN që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit "Sinjalizimi Horizontal, Vertikal dhe paisjeve rrugore ne komunen e Gjilanit", me numër të prokurimit 651-22-10313-2-1-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik të e-prokurimi me datë 10/08/2023, ka pranuar ankesë nga OE "INTRAST"SH.P.K., për aktivitetin e prokurimit "Sinjalizimi Horizontal, Vertikal dhe pajisjeve rrugore ne Komunën e Gjilanit", me numër të prokurimit 651-22-10313-2-1-1, iniciuar nga KUVENDI KOMUNAL–GJILAN në cilësinë e autoriteti kontraktues (AK).

Zyra e pranimit të ankesave pas pranimit të ankesës, gjatë verifikimit preliminar nëse ankesa është dorëzuar sipas rregullave dhe dispozitave ligjore, ka konstatuar se ankuesi për ankesën në fjalë, nuk ka ofruar dëshminë siç kërkohet me pikën 10 paragrafi 1 të nenit 111 të LPP-së.

Nisur nga fakti se OE ankesës së lartcekur, nuk i ka bashkangjitur konfirmimin e bankës për tarifën, zyra për pranimin e ankesave përmes sistemit e-prokurimi ka kthyer ankesën për plotësim tek OE-Ankues sipas sistemit elektronik, dhe po ashtu me datën 18.08.2023 përmes email-it e ka njoftuar OE si më lart se i njëjti nuk i ka bashkangjitur formularin për sigurim të depozitës të Ankesës, duke i sqaruar, se i njëjti duhet të ridërgohet e plotësuar me konfirmim të bankës për tarifën e ankesës në fjalë. njëherit ishte njoftuar se nëse nuk vepron sipas udhëzimeve të OSHP ankesa e tij do të hedhet si e palejuar.

Por, edhe përkundër këtij njoftimi dhe sqarimi të OSHP-së, Ankuesi nuk e ka kompletuar ankesën e tij me tarifën e depozitës së sigurimit të ankesës në fjalë.

Nga provat e prezantuara vlerësohet se ankesa e parashtruar nga OE " INTRAST " SH.P.K., e datës: 10/08/2023 (protokoll 564/2023), për aktivitetin e prokurimit me titull me "Sinjalizimi Horizontal, Vertikal dhe pajisjeve rrugore ne Komunën e Gjilanit" konsiderohet si e pa kompletuar sepse ankuesi nuk ka deponuar tarifën e sigurimit të ankesës së tij siç kërkohet në piken 10 paragrafi 1 të nenit 111 të LPP-së lidhur me nenin 118 të LPP-së. Andaj procedura e shqyrtimit të kësaj ankese përfundon në këtë fazë duke e hedhur të njëjtën si jo e plotë ngase kjo ankesë nuk plotëson kushtet për tu proceduar më tutje siç kërkohet dispozitat ligjore të lartcekura.

OSHP i vë në dijeni OE ankues për mundësinë e zbatimit të nenin 118 paragrafi 4 cituar: Nëse paneli shqyrtues konstaton se cilado nga pretendimet e bëra në ankesë janë të rrejshme, OSHP mund të kërkojë nga parashtruesi i ankesës që të paguajë një gjobë shtesë deri në pesëmijë (5.000) Euro, duke ju referuar në rastin specifik nenit 111 paragrafi 10.

Autoritetit kontraktues "KUVENDI KOMUNAL-GJILAN" mund të vazhdoj më tutje me aktivitetin e prokurimit (e përshkruar me sipër) nëse nuk ka ankesë tjetër për këtë aktivitet. Organi Shqyrtues i Prokurimit i vë në dijeni se në çdo aktivitet AK duhet të veproj konform dispozitave dhe autorizimeve ligjore siç përcaktohen ato me nenin 1, 6, 7, 27, 28, 59, 60, 65 të LPP-së.

Kryetarja e OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetarja e OSHP-së

Vjosa Gradinaj Mexhuani

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:
1x1 AK " INTRAST " SH.P.K..
1x1 "INTRAST" SH.P.K.
1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së